

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali “Hyseni”, eksperti: Është në pikëpyetje siguria kombëtare, SPAK të zbardhë si janë përdorur informacionet
ADRESA	https://lajmifundit.al/skandali-hyseni-eksperti-eshte-ne-pikepyetje-siguria-kombetare-spak-te-zbardhe-si-jane-pedorur-informacione-e-klasifikuara-i1338475
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	deleted

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:48:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 21:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e51bee5d7c9c80cae61d43639b56fc5178acc4483bc16b59379150fb1b21cc
TEKSTI	a3916c133ff0414ceac9fceece3e5d802d5a09fcbd7bd53d41d2bad8241174b0
PAMJA	7ba68a8be648a764e22654676186dc148e79545963c2637087b42be23a77112e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e9aff4db319a0f2f4c3bace76623380006bc489237b6be396b9af867d13ec4f8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e9aff4db319a0f2f4c3bace76623380006bc489237b6be396b9af867d13ec4f8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Skandali "Hyseni", eksperti: Është në pikëpyetje siguria kombëtare, SPAK të zbardhë si janë përdorur informacionet [Lexo lajmin e plotë](#) →

Elijona 'thyen' heshtjen/ Flet për herë të parë për ndarjen me Klodin, ja reagimi i saj i fundit [Lexo lajmin e plotë](#) →

"Jo në emrin tim"/ Diaspora shqiptare në SHBA proteston para OKB-së në New York: Lironi heronjtë tanë! [Lexo lajmin e plotë](#) →

'Rama do të ikë për 10 ditë, fjalë burrash'/ Nëna u bën thirrje të rinjve: Mos rini në kafe, ejani këtu! [Lexo lajmin e plotë](#) →

EMRI/ Arrestohet në Itali 47-vjeçari, i dënua me 15 vite burg për trafikimin e emigrantëve [Lexo lajmin e plotë](#) →

Skandali "Hyseni", eksperti: Është në pikëpyetje siguria kombëtare, SPAK të zbardhë si janë përdorur informacionet



LAJMI FUNDIT / 23 SEPTEMBER 2026, 21:40

Shpërndaje

AKTUALITET



Eksperti i sigurisë kombëtare, Gerti Metani, deklaroi se përfshirja e ish-drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni, në hetimin ndaj Ergys Agasit ka cenuar, sipas tij, funksionimin e institucionit të sigurisë.

Gjatë një interviste në edicionin qendror të lajmeve në Vizion Plus me Alkesandër Furxhi, Metani kritikoi gjithashtu mekanizmat e kontrollit parlamentar dhe mbikëqyrjen e institucioneve ligjzbatuese, duke pretenduar se kanë pasur mangësi në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Metani u ndal edhe të komunikimet mes Hysenit dhe Agasit, të cilat janë pjesë e materialeve të hetimit të SPAK dhe kanë ngritur dyshime për një marrëdhënie personale mes tyre. Sipas tij, kombinimi i këtyre komunikimeve me dyshimet për përdorim të informacionit institucional përbën një çështje që prek sigurinë kombëtare.

Ai theksoi se hetimet e SPAK pritet të zbardhin më tej rolin e personave të përfshirë dhe mënyrën se si janë përdorur informacionet e klasifikuara.

Intervista e plotë:

Aleksandër Furxhi: Atëherë a është cenuar sipas jush realisht siguria kombëtare? Çfarë rreziku konkret ka për shtetin?

Gerti Metani: Pa diskutim që siguria kombëtare është e cenuar duke qenë se kreu i institucionit më të rëndësishëm që menaxhon informacionin kriminal dhe sektorët e tjerë që kanë të bëjnë me

MOTI NË TIRANË

Tirana, Albania

POLITIKË

"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..." / Aktivistja i zë pritë deputetes së PS në zyrat e Kuvendit, kërcet debati (VIDEO)

POLITIKË

"Pse u hoq dëshmia e penalitetit dhe për kë?": Deputetja e PS, Koçeku, ngre pikëpyetje për Universitetin e Shkodrës

TRENDING

8,500 dëshmi konkrete të mbështetjes financiare nga sigurimi shëndetësor në SIGAL

One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi

korupsionin, pastrimin e parave dhe mbikëqyrjen e agjencive ligjbatuese është përfshirë në një megaskandal. Në vend që të ndihmonte organet e policisë dhe prokurorisë, në këtë rast SPAK-un, që të zbardhte hetimet dhe të ndihmonte në fundin e arratisë së personit Ergys Agasi, drejtuesja e institucionit ndihmonte këtë person që të vazhdonte arratinë e tij. Për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera që hetimet do t'i zbardhin më vonë, institucioni ka çeduar në ofrimin e sigurisë dhe në mbrojtjen e interesit kombëtar shqiptar.


Aleksandër Furxhi: Shërbimi Informativ Shtetëror normalisht është në varësinë e kryeministrit dhe ai i raporton, jep llogari e është përgjegjës përpara Parlamentit me ligj, ku raporton të paktën një herë në vit. Pyetja është: a kanë funksionuar, si mendoni ju, mekanizmat e kontrollit parlamentar ndaj Shërbimit Inteligjent të Shqipërisë gjatë tre viteve që Vlorë Hyseni e ka drejtuar shërbimin?

Gerti Metani: Pa diskutim që shërbimi informativ lidhet me Kryeministrinë. Vetë kryeministri propozon drejtuesin e shërbimit informativ, i cili më pas dekretohet nga presidenti. Midis Shërbimit Informativ dhe Kryeministrit është një Inspektor i Lartë i cili bën koordinimin e veprimeve dhe çon porosinë në dy kahe të ndryshme. Nga ana tjetër, Parlamentarët (komisioni i ligjeve dhe komisioni për sigurinë kombëtare) janë prezentë në monitorimin e institucionit. Kanë patur gjithë kohën dhe mjetet e nevojshme që të mbikëqyrin siç duhet Shërbimin Informativ. Jemi sot përpara faktit të kryer që një person në krye të institucionit ka shpërdoruar detyrën, ka kryer vepra penale dhe ka njoftuar institucionin e sigurisë që është partner i aleancës së NATO-s, e cila besueshmërinë tek përpunimi i informacionit e ka shumë herë më të rëndësishme se individin vetë.

Aleksandër Furxhi: Përveç cënimit të aspektit moral të çështjes, flasim për sigurinë kombëtare. Çfarë ndodh nëse mekanizmat që sigurojnë pikërisht atë që quhet siguria kombëtare dështojnë konkretisht?

Gerti Metani: Konkretisht, prej vitesh mekanizmat që monitorojnë institucionet ligjbatuese në vendin tonë kanë çeduar, duke nisur me prokuroritë, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, inspektoriatet të ndryshme dhe komisionet parlamentare. Deputetët e të dyja partive të mëdha që kanë shumicën në këto komisione kanë çeduar në mbikëqyrjen dhe mirëfunksionimin e tyre. Probleme të theksuara janë parë në Policinë e Shtetit, Policinë e Burgjeve, Forcat Zjarrëfikëse, Emergjencat Civile, AMP dhe sot edhe në Shërbimin Informativ. Ky i fundit ruan anonimatin deri në atë pikë sa kemi edhe tenderime e prokurime që nën hijen e dyshimit nuk kanë kaluar filtrat e duhur të procedurës. Të gjitha këto çedime, bashkë me çedimin e institucionit të Presidentit të Republikës, e bëjnë Shqipërinë një vend më vulnerabel që nuk garanton rend dhe siguri për qytetarët.

LEXONI GJITHASHTU



Elijona 'thyen' heshtjen/ Flet për herë të parë për ndarjen me Klodin, ja reagimi i saj i fundit



"Jo në emrin tim"/ Diaspora shqiptare në SHBA proteston para OKB-së në New York: Lironi heronjtë tanë!



'Rama do të ikë për 10 ditë, fjalë burrash'/ Nëna u bën thirrje të rinjve: Mos rri në kafe, ejani këtu!

Aleksandër Furxhi: Dhe një pyetje e fundit e cila në fakt ka kërshëri në opinionin publik. Duket që marrëdhënia mes Vlorë Hysenit dhe Ergys Agasit është më shumë se shoqërore, është intime. Çfarë ndikimi ka në të gjithë këtë skandal ky fakt?

Gerti Metani: Ka kohë që dyshohet për marrëdhënie intime të zotit Agasi me disa persona të caktuar në krye të institucioneve shtetërore, dhe tani po shikojmë një marrëdhënie intime të zbuluar nga përgjimet dhe nga dokumentacioni i dosjes së SPAK-ut. Besoj se në të ardhmen, pas përpunimit të USB-së dhe materialeve të tjera të sekuestruara nga SPAK, do të kemi raste të tjera të kësaj situatë. Kur kemi një miks të marrëdhënies intime, mungesës së profesionalizmit, shpërdorimit të detyrës dhe përkrahjes së autorit të kimit, ne kemi mundësi të shikojmë një skenar hollivudian të shkatërrimit të institucionit dhe të sigurisë publike. Kjo tregon se burimet njerëzore në këto institucione nuk qenkan në shërbim të vendit apo kushtetutës, por në shërbim të

POLITIKË

"Bela me Taon janë shokë, do bëhet kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlorë Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK

POLITIKË

"Territorialja", përplasja te ligjet, demokratët braktisin mbledhjen, PS vijon e vetme punën

ME TE LEXUARAT

"Zbraz karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutë 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

ME TE LEXUARAT

“Zbraz i karika’torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plote](#)



Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plote](#)



Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plote](#)



Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plote](#)



“Askush nuk është mbi ligjin”/ Rama shkarkon menjëherë Vlorë Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plote](#)



Sekuestrohet hoteli “Central Park Premium” në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plote](#)



“Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot”/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropë u hap

[Lexo lajmin e plote](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)